



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 329 / Prot.

Lënda: *Dërgim rezolute për dijeni*

Drejtuar:

Tiranë, më 23.05.2018

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

TIRANË

Bashkëlidhur ju dërgojmë për dijeni:

Rezolutë "Për vlerësimin e veprimitarës së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2017".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ





REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke njojur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;
- Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit finanziar e bankar;
- Duke njojur kuadrin ligjor dhe parimet bazë, mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Agjencisë;
- Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të:

- Përmbushjes së objektivit në drejtim të përforcimit të stabilitetit financiar në vend me zgjerimin e skemës me subjekte të sistemit jobankar dhc me përfshirjen e depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare;
- Konsolidimit të infrastrukturës informatike, në funksion të një proccsi kompensimi të shpejtë dhe të saktë të depozitivesve në rast të një ngjarjeje sigurimi;
- Administrimit me efektivitet të mjeteve financiare, duke diversifikuar portofolin me investime në maturitet më afatgjatë;
- Angazhimit të Agjencisë në rritjen e nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimit të depozitivesve përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave;

- Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të nevojshme për përmbushjen e mandatit ligjor të Agjencisë;

Kuvendi kërkon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave, për vitin 2018, të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Në funksion të transparencës dhe informimit, të hartojë rregulla dhe procedura të qarta për publikimin e vendimeve dhe materialeve të miratuar nga Këshilli Drejtues, duke respektuar kusizimet e legjisacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënavë konfidenciale dhe tregtare.

- Të monitorojë në vazhdimësi plotësimin e kushteve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, nga ana e shoqërive të kursim-kreditit, në nxitje të një biznesi të shëndetshëm dhe afatgjatë të tyre.

- Të shtojë mjetet e promovimit të skemës së sigurimit të depozitave dhe të vlerësojë impaktin e fushatave promovuese te publiku i targetuar me anë të anketimeve të përvitshme.

- Të përditësojë politikat dhe procedurat operacionale në drejtim të përputhshmërisë e skemës së sigurimit me parimet themelore të skemave efektive të sigurimit të depozitave.

- Të vazhdojë bashkëpunimin me anëtarët e rrjetit të sigurisë financiare dhe shoqërítë e kursim-kreditit, për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend dhe mbrojtjen e interesave të depozitivesve.

- Të mirinformojë depozitesit në lidhje me masat e ndërmarra nga ana Bankës së Shqipërisë në kuadër të strategjisë së deeuroizimit.

Miratuar në datën 17.5.2018